



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 11, 12 par.12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27 e datës 03.06.08, nenit 22 dhe 23 të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 28. 02.2018, pas shqyrtimit te propozim vendimit te Kryetarit miratoi këtë:

**RREGULLORE
MBI TAKSËN ADMINISTRATIVE PËR DHËNIEN E LEJES SË NDËRTIMIT
DHE TARIFAT PËR RREGULLIMIN E INFRASTRUKTURËS**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i miratimit të Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna të krijoj burime të të hyrave vetanake buxhetore në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal

**Neni 2
Objekti i rregullimit**

Me këtë Rregullore përcaktohen taksat dhe tarifat, obliguesit, procedura e pagesave dhe mënyra e llogaritjes për:

- 1.Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit,
- 2.Tarifat rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë dhe
- 3.Tarifat rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë

Neni 3 Fushëveprimi

Taksat dhe Tarifat e përcaktuara me këtë Rregulllore i zbaton Drejtoreti për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 4 Obliguesit

Obligues të pagesës të tarifave të përcaktuara me këtë rregullore janë personat fizik dhe juridik kërkesat e të cilëve miratohen për leje ndërtimore..

II. TAKSA ADMINISTRATIVE

Neni 5 Taksa administrative për dhënien e lejes së ndërtimit

- 1.Taksa administrative për nxjerrjen e vendimit e lejes së ndërtimit, është buxheti i planifikuar i organeve kompetente komunale për dhënien e lejes së ndërtimit, mbikëqyrjen e ndërtimit, inspektimin e ndërtimit, certifikatën e përdorimit si dhe zhvillimi dhe azhurimi i dokumenteve të planifikimit, i përpjesëtar me numrin total të metrave katrorë të lejuar me leje ndërtimore në vitin paraprak.
2. Llogaritja e taksës nga paragrafi 5.1. i këtij neni, bëhet në sipërfaqe (m^2) bruto të objektit, sipas dokumentacionit ndërtimor – projektit kryesor të prezantuar, për të cilin është dhënë miratimi dhe lejohet ndërtimi.
3. Llogaritja e taksës nga parografi i kësaj pike, bëhet me Konkluzion, të lëshuar nga DPUMM.
- 4.Taksa administrative për dhënien e lejes së ndërtimit, do të jetë $2.20 \text{ €} / m^2$,
5. Përjashtim nga paragrafi 5.2., nga sipërfaqja bruto hiqet shtresa e termoizolimit.
- 6.Baza dhe mënyra e llogaritjes së lartësisë së taksës, si në paragrafit 1 dhe 2 të kësaj pike, është dhënë në tabelën e shpenzimeve për leje të ndërtimit dhe shpenzimet për kalkulimin e tarifave rregullative për rritjen e dendësisë së infrastrukturës, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij Vendimi.
- 7.Rrjedhja e afatit për pagesën e taksës, sipas këtij vendimi, fillon ditën e parë pas marrjes në dorëzim të Konkluzionit për llogaritjen e taksës përkatëse, dhe ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë.
8. Leja e ndërtimit nuk mund të jepet në dorëzim pa provën mbi pagesën e kompensimit të llogaritur.
9. Taksa administrative për leje ndërtimore për punët ndërtimore që nuk maten me metër katror ose që përmbajnë pjesë që nuk mund të maten me metër katror ose që kanë karakter të veçantë, përcaktohen duke shumëzuar vlerën investive të ndërtimit me tarifën e përqindjes së vlerës së investimit, sipas shprehjes:

vlera e projektit X tarifa e përqindjes së vlerës = taksa administrative për leje ndërtimore

Për punë ndërtimore që nuk maten me metër kator ose që përmbajnë pjesë që nuk mund të maten me metër kator ose që kanë karakter te veçantë, do të zbatohen taksat e publikuara që janë përcaktuar nga MMPH.

III. TARIFAT

Neni 6

Tarifa rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë

1.Kjo tarifë do të aplikohet pas kërkesës të aplikuesit për leje ndërtimore, në rastet kur Komuna dhe aplikuesi lidhin Marrëveshje zhvillimore për infrastrukturë në tokën ku do të ndërtohet objekti për të cilin kërkohet leja ndërtimore, sipas së cilës Komuna obligohet për ndërtimin e infrastrukturës.

2.Aplikuesi për leje ndërtimore, konform paragrafit paraprak, duhet të paguaj tarifën rregullative me ndikim të drejtëpërdrejtë në infrastrukturë në lartësinë e kostos së shpenzimeve të Komunës për ndërtimin e infrastrukturës.

Neni 7

Tarifat rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës

1.Tarifa për ndikim nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës, përcaktohet në bazë të buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin aktual, përkatesisht të shumës së përgjithshme që pritet të shpenzohet për arsim, shërbime publike, mbrojtje dhe shpëtim, shëndetësi dhe mireqenie sociale, arsim, kulturë, rini dhe sport.

2.Lartësia e tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës për njësitë e reja të banimit, për ndërtimet e kategorisë I **dhe II** do të jetë **157.45 €**.

3. Kjo tarifë nuk do të zbatohet për ndërtimet e kategorisë se I-re, shtepite individuale te banimit ne sipërfaqe deri ne **200m²**, të cilat nuk jane per treg.

4. Llogaritja e tarifës nga paragrafi 1 bëhet në sipërfaqe (m²) neto të njësive të reja të banimit, e cila përcaktohet si vijon:

- a. $Sn=\Sigma (S.h. \times k)$, ku:
- b. Sn- Sipërfaqja neto e banesës;
- c. S.h.- sipërfaqja e hapësirës përkatëse në banesë;
- d. k- koeficient.

5. Koeficienti "k" për sipërfaqet e ndryshme në banesë ka vlerë të ndryshme, si vijon: të gjitha hapësirat prej hyrjes kryesore në banesë apo në shtëpi individuale të banimit, në shërbim të tyre, duke mos llogaritur sipërfaqen që zënë muret, kanë koeficient k=1,

- a. ballkonet k=0,5,
- b. loxhat k= 0,75,
- c. tarracat e mbuluara k=0,5,
- d. tarracat e pambuluara k=0,25,

e. depo brenda banesës $k=0.5$.

6. Meqë nuk krijojnë dendësi, nga tarifa për ndikimin e densitetit të infrastrukturës perjashtohen:

- a. lokalet afariste,
- b. hapësirat e përbashkëta në ndërtesat e banimit në bashkëpronësi si: para hyrjet, ashensorët, shkallët, shkallet kundër zjarrit, korridoret, kthinat teknike, depot, hapësirat për këshillin shtëpiak, bodrumet, garazhet etj;
- c. hapësirat ajrore në kuadër të objektit;
- d. pasazhet;
- e. kulmet e pashfrytëzuara;
- f. tarracat në bashkëpronësi dhe para lokaleve; dhe
- g. kthinat tjera të ngashme që nuk konsiderohen hapësira për banim.

7. Këtë tarifë e aplikon dhe e përcakton Drejtoreti për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrotje të Mjedisit, sipas formulës në vijim:

8. Metrat katorr të objektit të banimit për të cilin lëshohet leja ndërtimore pjesëtohen me numrin 50 (sipërfaqe e supozuar për një banues) dhe shumëzohen me vlerën e shpenzimeve të pritura për shërbime arsimore, shëndetësore, kulturë, rini dhe sport për kokë banori sipas Buxhetit të vitit aktual.

9. Kalkulimin e kësaj tarife për vitet në vijim, në pajtim me paragrafin 3 të këtij nenit, do ta bëjë Drejtoreti për planifikim, urbanizëm dhe mbrotje të mjedisit duke u bazuar në shënimet zyrtare të Drejtoretit për Buxhet dhe Financa për vlerën e shpenzimeve të pritura për shërbime arsimore, shëndetësore, kulturë, rini dhe sport për kokë banori sipas Buxhetit të vitit aktual.

Neni 8 Lirim nga taksat dhe tarifat

1. Nga lartësia e taksës dhe tarifave të përshkruara në nenet 5, 6, dhe 7 do të lirohen poseduesit e lejeve të lëshuara për objektet e interesit publik, të ndërtuara nga investimet kapitale të Komunës dhe niveli qendror, të ndërtimeve për nevojat e zgjidhjes së çështjes së banimit të rasteve sociale me investime në bazë të donacioneve, objektet për përfaqësuesit diplomatikë ku investuese janë shtetet e huaja, investimet publiko-private dhe objektet me destinim fetar.
2. Për lirimet nga tarifat e përcaktuara sipas paragrafit 17.1, duhet të prezantohen vërtetëtime nga institucionet përkatëse.

IV. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 9 Kërkesa për rishqyrtim dhe ankesa

Obliguesi, i pakënaqur me lartësinë e caktuar të tarifës sipas kësaj Rregulloreje, mund të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim ose ankesë në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën administrative.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 10
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për tarifat ndërtimore Nr.15-011 e datës 29.05.2014.

15Nr. 011 - 12877
Lipjan, më 01. 03. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESI I KUVENDIT
Daut Azemi

